




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Nr.06/2021

**Bordi për Ankesa**, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2103/277/BA/nn të datës 10.03.2021 të parashtruesit “Radio Televizioni i Kosovës-RTK 1”, të përfaqësuar nga Liridon Dalipi të paraqitur ndaj Vendimit Ref:2102/168/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 mori këtë:

### V E N D I M

**APROVOHET pjesërisht** si e bazuar Ankesa Ref:2103/277/BA/nn e datës 10.03.2021 e parashtruesit “Radio Televizioni i Kosovës-RTK 1”, i përfaqësuar nga Liridon Dalipi, e paraqitur kundër Vendimit Ref:2102/168/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave vetëm sa i përket shqiptimit të gjobës prej pesë mijë (5000) euro, të zbritet në katër mijë (4000) euro, ndërsa pjesa tjetër e Vendimit mbetet në fuqi.

### A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref:2102/168/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 i ka shqiptuar gjobë “RTK 1” në shumën prej pesë mijë (5000) euro, në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 për shkelje të nenit 49 paragrafi 6 të Ligjit Nr.033/L-037 për zgjedhje në Republikën e Kosovës.

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “RTK 1” ka parashtruar Ankesë Ref:2103/277/BA/nr me datën 05.3.2021 pranë Bordit për Ankesa, për shkak se: nuk janë vlerësuar në mënyrë objektive rrethanat faktike dhe ka shqiptuar gjobën, si dhe ka kërkuar nga BA të shqyrtojë të gjitha provat që janë në shkresat e lëndës dhe të aprovojë Ankesën si të bazuar dhe të anulojë Vendimin e lartcekur të KPM-së.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “RTK 1”, si dhe ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha provat

tjera që gjenden në shkresat e lëndës, të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Ref:2102/168/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së Vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike, duke u bazuar në dispozitat materiale dhe procedurale që rregullojnë fushën e Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa edhe përkundër shkeljes së Palës ankuese në bazë të Vendimit kontestues, për zvogëlimin e gjobës si në dispozitivin e këtij Vendimit ka vendosur për shkak të krizës financiare globale si pasojë e Covid 19, e cila krizë ka ndikuar edhe në fushën e mediave.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores BA-2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij Vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi mund të nicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:  
-Palëve dhe  
-Arkivit të KPM-së.



Ylber Fetahaj  
Kryetar i Bordit për Ankesa